

VENDIM
Nr.834, datë 30.11.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.691, DATË 21.5.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJEVE
DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES
VENDORE, BASHKIA PËRRENJAS, TË QARKUT TË ELBASANIT”, DHE PËR DISA
NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1642, DATË 17.5.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
BASHKISË PËRRENJAS, TË QARKUT TË ELBASANIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e një pakësimi në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, të transferuara në pronësi të bashkisë Përrenjas. Lista është me 1 (një) fletë dhe mban numrat e pronave 501 deri në 502.

2. Miratimin e një shtese në listën e pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të bashkisë Përrenjas. Lista është me 1 (një) fletë, fillon me numër prone 883 e mbaron me 887.

3. Listat e ndryshuara dhe tabela me lidhjen numër 1(një) i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

4. Ngarkohen Minisria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Përrenjas, e qarkut të Elbasanit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha